

VENDIM
Nr. 306, datë 20.4.2016

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E PUNËVE TË
BRENDSHME TE AGJENCIA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË
INTEGRUARA (ADISA), TË MJEDISEVE TË KATIT PËRDHE TË PRONËS ME
EMËRTIMIN “SHTËPIA E USHTARAKËVE”, FIER, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË
VENDIMIN NR. 250, DATË 24.4.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI
MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Punëve të Brendshme tek Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), të mjediseve të katit përdhe, me sipërfaqe 396 (treqind e nëntëdhjetë e gjashtë) m², të pronës me emërtimin “Shtëpia e Ushtarakëve”, me vendndodhje në Fier, për t’u përdorur si mjedise pune për ushtrimin e veprimtarisë administrative të ADISA-s, sipas formularit dhe planimetrisë që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Sipërfaqja prej 396 (treqind e nëntëdhjetë e gjashtë) m², e ndodhur në katin përdhe, pjesë e pronës me emërtimin “Shtëpia e Ushtarakëve”, me vendndodhje në Fier, e përcaktuar në pikën 1 të këtij projektvendimi, të hiqet nga listat e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore që i bashkëlidhet vendimit nr. 250, datë 24.4.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik”, të ndryshuar.

3. Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta japë me qira ose ta tjetërsojë atë.

4. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) dhe krye-regjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE (Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Identifikoi: Matilda Qesja Pergjegjese e Sektorit Juridik, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse dhe Godinave, Agjencia e Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)				Supervizoi: Blerta Xhako Koordinator, Departamenti I Inovacionit dhe Mireqeverisjes, Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike						
Agjencia e Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)				Aprovoi: Saionira Pino Koordinator i Kabinetit, Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike						
Fusha e perdorimit te Prones. Administrate										
Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksionet e cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti per pergjigjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11

[illegible]

